



Planuar / Doretuar Primitje/Produkt Received/Delivety	21. 09 2023	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHQYRTIM	6179/2023		1/2



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1132/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtar, me Sabile Avdyli- Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1132/2023 të datës 01.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted], kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme/DMZP, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.1132/2023 të datës 01.09.2023 të parashtruar nga ankuesi, [redacted]

A r s y e t i m

[redacted] (tani e tutje referuar si ankuesi) me datën 01.09.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5912/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1132/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Njësisë Përgjegjëse/DMZP, lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm - Shërbimi Korrektues i Kosovës, me numër reference RN00012058 i shpallur me datë 12.07.2023 në SIMBNJ, ndërsa më datë 08.09.2023, i njëjti, përmes shkresës me numër protokollit 6017/2023, për arsye personale është tërhequr nga ankesa A.nr.1132/2023 e datës 01.09.2023.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë Kërkesën e datës 08.09.2023 të ankuesit, për tërheqje nga ankesa, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për

përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1132/2023 të datës 01.09.2023, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1132/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

